

**Shkolla 12 vjeçare**
www.universumcollege.org

Në shkollën fillore dhe të mesme UNIVERSUM regjistrimet kanë filluar në klasën 1-5, klasën 6-9 dhe klasën 10. Apliko tani.

**TOP 1000 shkollat në botë**

Eduniversal thotë: Universum në top 1000 shkollat më të mira të botës. I vetmi në Kosovë. Kliko për më shumë.

Like us on Facebook.

Të Tjerë



Like 39k

45

Follow 7 Pamela

"Vogue" Brazi

TJETRI BRENDË NESH - FROM PRISHTINA WITH LOVE

02 Qershor 2013 21:25, Nga Mirela Kumbaro

Nuk doja ta humbisja për të tretën herë festivalin ndërkombëtar të letërsisë që organizohet në Prishtinë nga Qendra Multimedia dhe nga organizata kulturore Beton nga Beogradi.

Programet joshëse të dy edicioneve të para më shtynë të rikthehesha në fundjavën e 10-12 majit në Prishtinë për të ndjekur Festivalin e Poezisë, të Letërsisë, por edhe të Muzikës e të Koreografisë, të Zërave e të Gjuhëve, të Artistëve e të Njerëzve. Polip 2013. Polip si gjallesa e detit me tetë këmbë që mes vetes përzihen e me të tjera lidhen. Për të dhënë nga Vetja e për të marrë nga Tjetri. Protagonisti i madh i Polip 2013 ishte pikërisht ky Tjetri, brenda skenës së cilësuar nga festivali si "Letërsia e botëve të ndara".

Që në program, të paktën dy elemente i kisha të sigurta që do më joshnin pafund:

- Kullën e Babelit, me pjesëmarrjen e rreth 12 gjuheve, 13 vendeve, 14 kombësive, 30 zërave krijues.

- Temën time të preferuar: "Letërsia dhe Tjetri i panjohur", dhe jo vetëm këtë por edhe fronin për të drejtuar panelin me këtë temë.

Dhe më pas, çdo gjë tjetër ishte vetëm kënaqësi e fituar: lexime, muzikë, autorë, poetë, përkthim, debat, teatër, shoqëruar me një gotë raki Kosove!

Jeton Neziraj dhe Sasa Ili?, Polip dhe Beton, Prishtinë dhe Beograd. Tri çifte këto të mjaftueshme për të ndezur fantazitë humane, etnike, shoqërore, nacionaliste, kulturore e artistike. Gjejeni vetë aty brenda se ku doni të rriini.

Humor dhe politikë

Unë vetë gjeta një frymë, një frymë të mirë, nga ajo që kishim

TË FUNDIT

15:45 Më 2012, 17 punëtorë humbën jetën në punë

15:37 Policia ballkanike, ide e mirë

15:26 "Ndikimi i teknologjisë në media"

15:25 Krasniqi: Duhet të ketë reciprocitet

15:19 Mourinho, zyrtarisht në Chelsea

15:17 Gjeorgjianët kërkojnë legalizimin e marihuanës

01 QERSHOR 2013

Nuk po hetohen krimet e luftës, por udhëheqësit e luftës

21

31 MAJ 2013

Kujtim për Bardhin

2

26 MAJ 2013

Korrigjimet në tekstet e historisë

24

23 MAJ 2013

Ku është Qeveria?

13

OPINIONISTAT E TJERË



Mufail Limani



Faton Raçi



Baton Haxhiu



Imer Mushkolaj

Të Tjerë

Më shumë opinionista

frikë se nuk do lindte dot në Prishtinën tonë. Ishte një sofër poezie dhe arti. Jo vetëm art por edhe politikë. Politikë?! Po, politikë me humor! Pjesëmarrësit ishin shkrimtarë e poetë nga Kosova, Gjermania, Kroacia, Serbia, Hungaria, Bosnja, Spanja, Maqedonia, Qipro, Izraeli, etj. Të gjithë ftoheshin të lexonin tekstet e tyre letrare, por më parë duhet të kalonin provën e zjarrit: një pyetje për politikën e ditës e cila shoqërohej me batutën ironike: "nuk po bëjmë politikë!" Kështu dy animatorët, serb dhe shqiptar, e pyetën poetin serb Tomislav Marković se ç'mendonte për marrëveshjen Thaçi-Daçic, por ai ndenji te raca e poetëve të cilët "parapëlqejnë të hanë vetveten". Pyetën gjermanin Ralph Hammerthaler nëse e kishte takuar gjë znj Merkel ta pyeste se çfarë do të bënte ajo me marrëveshjen, por Ralph gjermani, në të njëjtin ton humor, u përgjigj: "Ah, ajo do duhet të bëjë diçka, por edhe sikur jo, mirë do të jetë, sepse pas tri ditësh më në fund sot kisha ujë të ngrohtë në banesë në Prishtinë! Jam i lumtur!" dhe vijoi leximin e letërsisë së tij. "A do ta njohë Izraeli Kosovën?", u pyet Tal Nitzán, poete e përkthyesë e mençur nga Izraeli e cila, para se të lexonte poezinë e saj "Në kohë të kolerës", tha: "Unë e kam njohur, jam këtu!" Ndërsa poeti hungarez György Dragomán kur i hodhën batutën "si e keni politikën në Hungari?" ia ktheu: "unë kam jetuar diktaturën në Rumania deri 15 vjeç, e më keq se aq s'ka...". "Po ti Jolanda si ndjehesh në republikën që Spanja s'e ka njohur?" e pyetën poeten që vinte prej këtij vendi para se ajo të lexonte poezinë e saj "Një histori transformimi". Jolanda, vetë ishte nga Galicia, krahinë autonome në skajin veri-perëndimor të Spanjës, me një sipërfaqe gati sa Shqipëria dhe një popullsi po aq. Kjo pyetje me sa duket i shkoi në zemër të frustracioneve që shkaktohen kur i përket një pakice që flet një gjuhë ndryshe nga shumica, kur të shohin ndryshe dhe kur nuk arrin ta shpalosësh kulturën tënde të vogël se të mbytet ajo e madhja. E pra, ajo e gjeti tribunën e vet në Prishtinë për ta zbratur të gjithë këtë: "Më vjen shumë keq që s'e ka njohur, sepse ditën që do ta bëjë do të jetë më mirë edhe për Galician time". Nga publiku në sallë dikush ia priti: "Mos u mërzi bre! se e rregullojmë, kur Kosova ta njohë Galician, Spanja do ta njohë Kosovën!"

Identitet dhe letërsi

Vjen radha e shkrimtarit të njohur Beqë Cufaj, të cilin e prezantuan si autori kosovaro-gjerman, prej Gramaqelit të Deçanit, e që në anglishte Jeton Neziraj e pyeti: "Are you Kosovar, Albanian or German?" e që unë e përkthej: A je Ne apo ai Tjetri?

Pyetje me të cilën, ma do mendja, Cufaj duhet të jetë përballur shpesh në shpjegim të identitetit të tij që, besoj, nuk mund të copëtohet as në gjysma, as në të treta e as në grimca. Gjithsecili prej nesh ka një identitet të përbërë nga të gjithë elementët që na ngjizin, sipas një mase të veçantë që s'është asnjëherë e njëjta nga një individ tek tjetri, siç thotë Amin Maalouf, shkrimtari franko-libanez që i përket të njëjtës racë shkrimtarësh si Beqë Cufaj. Në fakt ky, përmes leximit e krijimit, u prezantua me çka u ndje më mirë, si shkrimtar, me romanin e tij të fundit "Projekt@party", ku gjenden edhe Ne edhe Tjetri. Përgjigjia më e mirë kjo, duke na treguar se në letërsi s'ka fikcion, ka veç realitete që i përkthejnë në letërsi.

Leximi i letërsisë së Cufajt, botuar me shumë sukses në botën gjermanishtfolëse, na zbriti, në shqip, në vendin pa emër që mund ta gjejmë kudo këtu poshtë e mund ta shohë kushdo që vjen prej atje lart. "Isha aty ku duhej të isha. Në Grand Hotel që këtu e quanin Hotel Grand. Një ndërtesë për të cilën thuhej se aty kanë fjetur dhe festuar kryetarë e kryeministra, shpëtimtarë e vrasarë, punëtorë e dembelë, shkatërrimtarë dhe ndërtimtarë."

Ne, të gjithë të ftuarit e Polip -it, ishim strehuar në Hotel Grandin e Prishtinës, mes historisë dhe të tashmes për disa, mes kujtimeve dhe vështrimit përtej, për ca të tjerë. "Asnjëherë s'kam qenë në një hotel me kaq shumë fantazma" tha poetja nga Tel Avivi, ndërsa ktheheshim duke përtypur ende me vete tekstin e Cufajt.

Vështirë të ndaje në ato tri ditë ku fillonte poezia e ku mbaronte jeta. Letërsia e Tjetrit të panjohur ishte historia e jetës tonë. Post-traumë për ne ballkanasit, jetë në traumë që vazhdon për izraeliten. Fëmijëri të kaluar në diktaturë për rumunin, e se mos vetëm për atë... Ndarje e mosdije për njerëzit përballë. Jo vetëm për qiprioten greke në vendin e vet që deri në vitin 2003 s'dinte asgjë për fqinjët e saj turq, por edhe për mua që vija nga Tirana e Blerina Rogova-Gaxhën, poeten nga Prishtina, fjalët e së cilës më mbeten në mend: "Në vitin e lindjes sime, 1982, Kosova ka qenë hapur me Serbinë, e mbyllur me Shqipërinë. Në 90-tat u mbyll me Serbinë u hap me Shqipërinë. " Çka më bukur pastaj e perifranoi ajo vetë, me vargjet lexuar nga libri i saj me poezi "Kate":

Ishte viti 1990 kur në shkollë mësonim për kancerin e shpirtit ballkanik

E përsërisnim vit për vit, me ditë dhe me orë

Dhe nuk e kishim të qartë cilat shpirtra lëviznin mushkërive të Ballkanit

Derisa kaluan vitet me nëntëshe

Dhe faji mbeti në mushkëritë e trupave të palëvizshëm

Poezia bëhet kështu gjuha kundër luftës, arma kundër regjimeve. Natyrisht poezia s'është e të gjithëve, por nëse poezia e ndryshon apo jo botën, ky s'është problemi i poetit. Me poezinë poeti ndryshon botën e tij, një copëz nga ndryshimi i madh, sepse poezia është armë e mbushur me të ardhme.

Tjetri brenda meje

Në sofrë për letërsinë e ballkanasit, të ish-jugosllavit apo edhe atë të gjermanit, u mblohdëm autorë, poetë, përkthyes, artistë, njerëz, për të "gjetur Tjetrin e panjohur" duke kujtuar se veten e kishim gjetur tashmë. Falë letërsisë e artit, pamë se ky Tjetri nuk është gjithmonë një i huaj i panjohur. Më shumë se sa i panjohuri, ai është Tjetri. Është jo vetëm ai që vjen nga një tjetër gjuhë, nga një tjetër kulturë, nga një tjetër histori. Jo vetëm ai që ndodhet në anën tjetër të botës, por edhe ai që jeton në fshatin përballë. Jo vetëm ai që s'flet gjuhën time, por edhe ai që flet të njëjtën gjuhë, por pak më ndryshe. Jo vetëm ai që flet gjuhën njësoj si unë, por edhe ai që thjesht mendon ndryshe. Pra ai që është ndryshe nga Unë. Tjetri është ai me të cilin nuk identifikohem sepse nuk më ngjan, sepse nuk bën pjesë te tufa ime.

Me fjalë të tjera, kufijtë që na ndajnë nuk janë domosdoshmërisht gjeografikë e aq më pak administrativë. Kufijtë i kemi brenda vetes. Kapërcimi i kufijve gjeografikë e kulturorë bëhet i mundur vetëm nëse arrijmë të zhvendosim kufijtë tanë të brendshëm. Për të udhëtuar diku tjetër, na duhet së pari të udhëtojmë brenda vetes. Në thelb, ndryshimi i imazhit për tjetrin fillon nga ndryshimi i imazhit që kemi për veten.

Kulla e Babelit

Krijimet lexohen në gjuhët origjinale dhe mbi ekranin gjigand shfaqen të projektuara përkthimet në anglisht. Lingua franca, por jo gjuhë e shpirtit. E thotë Umberto Eco se në poezi fjalët janë të vështira për t'u përkthyer pasi në to ka aq shumë rëndësi tingulli saqë përzgjedhja e fjalëve përcakton përmbajtjen.

Bisedat fillojnë në gjuhë të ndryshme, përkthehen spontanisht në anglisht, dikush harrohet në shqip, pastaj fillet serbisht. Kjo e fundit, pjesë e identitetit gjuhësor të Prishtinës e nxjerr jashtë loje përkthimin, banorët e dikurshëm të ish-Jugosllavisë, shumë ëmbëlsisht jepen pas ideve, humorit, estetikës, melodive të zërave, të gjitha këto s'kanë atdhe nacionalë, e pak rëndësi ka se në ç'gjuhë po thuhet. Unë, xhelozë prej padijes time në gjuhët silave, e dëshiruar të mos humbas asnjë grimë nga ajo atmosferë pasionante poezie e as nga ajo frymë e mirë njerëzore që çlirohej pa fund, kërkoj përkthim në një gjuhë çfarëdo, mjaft të jem brenda. - Nema problema! më thotë

Sasha. - U kry! ma pret Jetoni.

Dy batuta që sollën fort në kujtesë dy kohë të jetës time: atë të televizionit jugosllav që ndiqja në kohën e diktaturës për të parë vjedhurazi një çikë nga bota e përtej hekurave, si dhe ditën e madhe të pavarësisht të Kosovës kur i mbajtëm premtimin vetes dhe Bacës.

Dhe ja ku jam me të dy këto batuta, në këtë Kullë të Babelit. Tekstet që i kuptojmë në anglisht nuk janë aq të bukura sa tingëllimet e tyre në gjuhët origjinale që s'i kuptojmë, por që na magjepsin e na joshin. Lexojmë hebraisht, hungarisht, shqip, maqedonisht, serbisht ose kroatisht ose boshnjakisht, ose ish-jugosllavisht po të doni, por edhe greqisht, spanjisht, gjermanisht, e si stacion i detyruar, bëjmë një xhiro nga anglishtja e cila na duket befasi e zbehtë, e pabukur e që sërish më kujton njërin nga personazhet e romanit "Projekt@party" të Cufajt, ... me anglishten që i ngjante këmishës së tij të palarë,...

Heq sytë nga ekrani që të mos lexoj përkthimin. Më pëlqen më shumë të dëgjoj muzikalitetin e gjithë atyre gjuhëve të cilat, ndonjë të largëta, më qasen kaq të afërta duke i dhënë kuptim një poezie që s'kishte asgjë ekzotike, përkundrazi, më ishte po aq e afërt sa sytë e autorëve të tyre që më vështronin aty, teksa lexonin në atë skenë të ngrohtë, në katin përdhës të një pallati të Prishtinës.

U ndava nga ai festival duke u thënë miqve të vjetër e të rinj: E dua shumë Tiranën jo se e kam zgjedhur por, sepse aty kam lindur dhe jam rritur. E dua shumë Prishtinën jo sepse jetoj në të por, sepse e kam zgjedhur vetë.

10 0 0
 Recommend Tweet

Shpërndaje: [in](#) [G](#) [f](#) [su](#) [m](#)

Printo Email

KOMENTET (2)



LUTOJA
 2013-06-03 02:47:23

Kësaj i thonë bull shit modern. Harrojeni padrejtësinë dhe dhunimin. Letërsia është memorie, jo harresë oj derdimene!

E REKOMANDOJ (+0)

NUK E REKOMANDOJ (-2)



BLERIM R.
 2013-06-03 10:53:20

Lutoja merre jeten pak ma but vlla se nuk eshte fundi i botes, se cka eshte letersija per ty nuk dmth qe eshte per tjetrin eshte perceptim kulturor i secilit prej neve. Mireles film per ket shkrim te embel!

E REKOMANDOJ (+1)

NUK E REKOMANDOJ (-0)

Komento

Ndalohet përdorimi i gjuhës denigruese dhe fjalëve ofenduese ndaj individëve dhe ndaj grupeve specifike, si dhe komentimet që skanë të bëjnë me temën e artikullit. Moderatorët mbajnë të drejtën e fshirjes së komenteve që thejnë rregullat e komunikimit.

Emri:	Komenti:
E-mail:	
Ku / Vendndodhja:	
0988 <input type="text"/> Kodi:	

Karaktere të mbetura: 800

Komento**E presin Sulltanin**

Ministria e Punëve të Jashtme duket se nuk do të iniciojë shkarkimin e Ambasadorit të Kosovës në Shqipëri, Sylejman...

më shumë

35 Komentë

Shperndaje

**Edita Tahiri opSION i PDK'së në Prizren?**

PDK po e shoh si opSION për Kryetarin e Prizrenit Edita Tahirin. Sipas udhëheqësve të PDK'së ,Zëvendëskryeminstrija mund...

më shumë

41 Komentë

Shperndaje

**Kodin e marrim në ITU ose përmes Shqipërisë**

Zëvendëskryeminstrija Edita Tahiri ka treguar se Kosova nuk do ta marrë kodin telefonik përmes Serbisë por do të...

më shumë

41 Komentë

Shperndaje

**OVL-UÇK: EULEX po shkatërron vlerat e luftës**

(E plotësuar) Organizata e Vetëneve të Luftës së UÇK-së ka reaguar ashpër ndaj arrestimeve të mbrëmshme që u kryera...

më shumë

126 Komentë

Shperndaje

Ky w ebsite kontrollon dhe menaxhohet nga Media Works. Të gjitha materialet në këtë w ebsite, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me të drejta autoriale të Media Works. Materialet në këtë w ebsite janë për shfrytëzimin personal tuaj dhe për qëllime jo-komerciale. Ato nuk mund të kopjohen, riprodhohen, ripublikohen, modifikohen, transmetohen, ose distribuohen në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Gazetës Express. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë w ebsite ose medium tjetër, pa lejen e Gazetës Express, është shkelje e drejtave autoriale dhe është i ndaluar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Impresum**Rss Feed**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara;